




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr Prot.
Dep. 2-0/DPK	B/Prot 01-550/16
Dep.	Prot No.
Nr. i faq.	Data
Broj stranica 03	Datum 09.02.2016
Nr. pages	Date
	PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.02.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-4460-15 për z.Naser Canolli–Kryeshef i Ndërrmarrjes Publike “Termokos” dhe Anëtar i Bordit të NP “Aeroporti i Gjakovës”, për shkak se ka kufizime, por nuk ka konflikt faktik të interesit në ushtrimin e njëkohësishëm të këtyre dy funksioneve publike.

II. Zyrtari i lartë z.Canolli mund të gjendet në situata të konfliktit “rast për rast” të interesit, por në raste të tilla ai është i obliguar që ta bëjë deklarin e atyre interesave dhe të tërhiqet nga vendimmarrja.

III. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. AKK-03-02-4586-15, për Zyrtarin e lartë, z.Naser Canolli–Kryeshef ekzekutiv në Ndërrmarrjen Publike “Termokos”, dhe njëkohësisht Anëtar i Bordit të Ndërrmarrjes Publike “Aeroporti i Gjakovës”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Duke qenë Kryeshef i Ndërrmarrjes Publike “Termokosi”, z.Canolli është në mesin e Zyrtarëve të lartë publik, që pos përgjegjësive dhe kompetencave që lidhen me këtë funksion, ai është i obliguar që ta bëjë edhe Deklarimin e pasurisë, e po ashtu është i obliguar që të parandalojë dhe të zgjedh vet çdo situatë të konfliktit të interesit (Neni 8, paragrafi 1, i Ligjit Nr.04/L-051).

Ligji për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051) ka disa dispozita që rregullojnë mospajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë aspekt, duke qenë se z.Canolli ushtron edhe funksionin e Anëtarit të Bordit të Ndërmarrjes Publike “Aeroporti i Gjakovës” që po ashtu konsiderohet funksion publik, vjen në shprehje Neni 15 paragrafi 2, i ligjit të lartëpërmendur, cili shprehimisht thotë:

2. “Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organit drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike apo shoqërisë aksionare me pronë publike, mirëpo nuk ka të drejtë kompensimi me pagë të rregullt, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme”.

II. Zyrtari i lartë publik gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik gjithmon duhet ta ketë parasysh faktin se ushtrimi i njëkohësishëm i dy funksioneve publike, qoftë me kufizime ose pa kufizime në kompenzim, mund ta sjell atë në ndonjë situatë të konfliktit rast pas rasti të interesit. Prandaj në situatë të këtilla zyrtari i lartë publik duhet të veproj në pajtim me dispozitat e nenit 13, paragrafi 1, 2, 3, të cilat shprehimisht thonë:

1. “Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarinin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit”.

2. “Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa me shpejt që të jetë e mundur”.

3. “Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar”.

Pretendimi se z.Canolli ushtron edhe funksionin e tretë publik (Drejtor i Zyrës për publikimin e gazetës zyrtare në Zyrën e Kryeministrit) tashmë nuk qëndron, sepse z.Canolli në AKK ka sjellë dëshminë zyrtare(DPK/DPKI-03-02/422/16), Vendimin nga Sekretari i Zyrës së Kryeministrit nr.prot.044/2016, që ai tashmë ka bërë pezullimin e dakorduar të marrdhënjes së punës në Shërbimin Civil, siç shkruan në këtë Vendim, konform dispozitave të nenit 89, paragrafi1, nënparagrafi 1.3 dhe paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

III. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

The stamp is circular with a purple border. The text inside the border reads "REPUBLIKA E KOSOVES" at the top, "AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT" on the left, "AGENCIJA PROTIV KORUPCIE" on the right, and "REPUBLIKA KOSOVA" at the bottom. In the center, there is a stylized logo of the agency. A signature in blue ink is written over the stamp, and a horizontal line is drawn below it.
/ Hasan Preteni /